



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas lëndës me vetë iniciativë KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 59-të, të mbajtur më 14.01.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-3779/1 datë 08.10.2021, e formuar me vetiniciativë të KSHPK-së lidhur me dyshimet për aktivitete gjatë procesit zgjedhor që paraqesin shkelje të Kodit Zgjedhor, **NDËRPRITET**.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, KSHPK-ja përcaktoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm sepse në rastin në fjalë është konstatuar se pretendimet nuk u konfirmuan.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda 12-3779/1 datë 08.10.2021 është ngritur me vetiniciativë të KSHPK-së lidhur me dyshimet për aktivitete gjatë procesit zgjedhor që përbëjnë shkelje të Kodit Zgjedhor dhe pasi është dëgjuar zëri në lidhje me informacionet e paraqitura në publik për Njoftimet se /// do të shpallë thirrje publike ndërkombëtare për prokurimin e thëngjillit për funksionimin e një blloku në /// dhe për vazhdimin e funksionimit të ///.

Gjegjësisht, pas shpalljes në disa media, më 7 tetor 2021, dhe pas njoftimit të dhënë nga drejtori i ///, ///, se /// është në plan të shpallë thirrje publike ndërkombëtare për prokurimin e thëngjillit për operimin e një bllok në ///, dhe për vazhdimin e funksionimit të ///, i cili më datë 07.10.2021 tashmë është publikuar dhe regjistruar në evidencën e/// me nr. 01-51/2021.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe përcaktimit të gjendjes faktike në rastin në fjalë , KSHPK-ja veproi ndaj lëndës në lidhje me shkeljet e mundshme të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe Kodit Zgjedhor.

Neni 8-a i Kodit Zgjedhor rregullon veprimtarinë që nuk mund të kryhen gjatë periudhës zgjedhore, ku paragrafi 1 alineal i të njëjtit nen theksohen ndalimet për fillimin e ndërtimit me fonde nga buxheti ose fondet publike ose me fonde të ndërmarrjeve publike dhe persona të tjerë juridikë që kanë kapital shtetëror në dispozicion të objekteve të reja në infrastrukturë si rrugë, ujësjellës, linja, kanalizim, kënde lojërash sportive dhe objekte të tjera ose objekte për aktivitete shoqërore - shkolla, kopshte dhe objekte të tjera, përveç nëse paraprakisht është paraparë. për këtë qëllim janë siguruar mjete nga buxheti, përkatësisht bëhet fjalë për realizimin e një programi të miratuar në bazë të ligjit në vitin aktual .

Pas shqyrtimit të rastit konkret, KSHPK-ja konstatoi se subjekti i shpalljes publike nuk i referohej aktiviteteve të renditura në nenin 8-a të Kodit Zgjedhor dhe as nuk konstatoi shkelje të nenit 34 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Nisur nga situata e mësipërme faktike, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit konstaton se në rastin konkret nuk ka pasur shkelje të nenit 8-a paragrafit 2 të Kodit Zgjedhor dhe as nenit 34 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, pas së cilës vlerësoi se Komisioni Shtetëror nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin dhe lënda të mbyllet dhe arkivohet.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në diapozitivin e këtij vendimi.



KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar
Goran Trpenoski

Përgatiti: M.r.K.Z, Këshilltar

Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së

